



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11 Qershor 2021

Nr. 402

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 1328, datë 13.04.2021 të qytetarit, përcjellë nga Institucioni i Presidentit të Republikës, për shkelje të parashikuar në Kodin Zgjedhor, ndaj Ministrit të Mbrojtjes, z. Niko Peleshi
- Kërkues:** Qytetar
- Ndaj:** Ministrit të Mbrojtjes, z. Niko Peleshi
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I.Vlerësimi paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 1328 prot., datë 13.04.2021 administruar me tonën me nr. 3706 prot., datë 13.04.2021, është përcjellë nga Institucioni i Presidentit të Republikës, ankimi i qytetarit I.L i cili pas nismës së bërë publike nga Presidenti i Republikës, ku u kërkohet qytetarëve të denoncin çdo parregullsi në lidhje me kryerjen e krimeve elektorale gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, pranë këtij institucioni, ka paraqitur denoncimin e tij në rrugë elektronike kundër Ministrit të Mbrojtjes, për veprime abusive nga e tij.



Sipas ankesës qytetari pretendon se, ministri ka shkelur të gjitha procedurat administrative duke përcaktuar sipas dëshirës së tij politike nevojat për kuotat e specializimit në mjekësi, duke përdorur nevojat e Forcave të Armatosura.

Qytetari bën me dije se:

- Asnjë mjek ushtarak nuk është në listë;
- Në listë ka specializime që nuk mund të kërkohen nga ushtria si psh. Pediatria;
- Ministri ka dhënë një kuotë, për një deputet aktual (Eugen Bojaxhiu).

Në cilësinë e provës, denoncuesi ka paraqitur 17 “letra mbështetëse” për 17 individë të cilët, në zbatim të vendimit nr. 23, datë 26.02.2021 të Senatit Skademik të UMT-së , janë mbështetur nga Ministri z. Peleshi, në kërkesën e tyre për të aplikuar në kuotat e Ministrisë së Mbrojtjes, në programet specializuese përkatëse. Gjithashtu, për këtë denoncues, Institucioni i Presidentit të Republikës ka kërkuar dhe ruajtjen e anonimatit të tij për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi.

Referuar nenit 23 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se *“Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi”*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht faktin nëse është apo jo organi publik kompetent, për shqyrtimin e tyre.

Juridiksioni dhe kompetenca janë parakushte procedurale që duhet të plotësohen në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie juridike procedurale e vlefshme.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.



Lidhur me këtë denoncim të qytetarit, i cili ka si objekt të tij “Shkelje të nenit 91 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se ky ankim është objekt shqyrtimi nga ana e tij.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3706/1 prot., datë 28.05.2021, i ka kërkuar Ministrisë së Mbrojtjes, informacion sqarues në lidhje me këtë procedurë të ndjekur nga Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi.

Me shkresën nr. 2634/1 prot., datë 02.06.2021, administruar me tonën me nr. 3706/2 prot., datë 4.06.2021, Drejtori i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes, z. Floria Kali, ka kthyer përgjigje nëpërmjet së cilës bën me dije se:

Procedura e ndjekur në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Universitetin e Mjekësisë mbi specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2020-2021, është zhvilluar në respektim të plotë të normave ligjore dhe nënligjore, duke ndjekur etapat si më poshtë:

- ✓ Përcaktimi kuotave;
- ✓ Miratimi i kuotave;
- ✓ Miratimi i letrave mbështetëse;
- ✓ Miratimi i kandidatëve fitues;
- ✓ Nënshkrimi i kontratave për fillimin e specializimeve.

Z. Kali gjithashtu sqaron se:

Bazuar në shkresën e ardhur nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, me nr. 193/3, datë 03.02.2021, i është kërkuar Ministrisë së Mbrojtjes dërgimi i propozimeve për kuotat e programeve të specializimeve afatgjata në fushën e Mjekësisë, për vitin akademik 2020-2021 dhe bazuar në këtë propozim të dërguar nga Ministria e Mbrojtjes, me vendimin e senatit akademik, janë akorduar 22 kuota pranimi, për programet e studimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë.



Ky proces rekrutimi, duke filluar që nga aplikimi kandidatëve e deri te shpallja e fituesve ka qenë i gjithi nën ndjekjen e vazhdueshme të Universitetit të Mjekësisë.

Në listat e kandidatëve që kanë filluar specializimin pranë Universitetit të Mjekësisë, 1 (një) mjek efektiv është i Forcave të Armatosura dhe 12 (dymbëdhjetë) mjekë janë nga jashtë radhëve të saj. Personeli që fillon specializimet nga jashtë radhëve të Forcave të Armatosura nuk trajtohet financiarisht gjatë periudhës së specializimit dhe në përfundim të saj, ky personel është i detyruar që të paraqesë në Ministrinë e Mbrojtjes kërkesën për mundësinë e punësimit në shërbimin shëndetësor të Forcave të Armatosura, kërkesë kjo e cila shqyrtohet sipas nevojave që ka Ministria e Mbrojtjes, për t'i punësuar në strukturën e FA-së, në ato funksione/specialitete/degë mjekësore ku e ka më të vështirë për t'i plotësuar me personel mjek ushtarak apo civil aktiv në Forcat e Armatosura.

Lidhur me kërkesën për kuotën “pediatri”, këtë specializim nuk e ka përfutur asnjë nga kandidatët. Specializimi në fushën e pediatriisë është kërkuar me qëllim hapjen në të ardhmen e një konsulte pediatrike për fëmijët e ushtarakëve të FA-së.

Lidhur me kuotën e dhënë për z. Eugen Bojaxhiu, bëhet e ditur se ka paraqitur kërkesën pranë Ministrisë së Mbrojtjes si edhe personeli tjetër që ka aplikuar te kategoria **jashtë radhëve** të forcave të armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes e ka pajisur me “letrën mbështetëse”, për të konkuruar pranë Universitetit të Mjekësisë, në degën “kirurgji e përgjithshme”. Pas testimave të bëra në këtë universitet, është shpallur fitues dhe me urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 546, datë 29.04.2021 është miratuar për të ndjekur specializimin, pa të drejta financiare.

III. Analiza ligjore

Neni 91, pika 3, i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”*.

Referuar sa më sipër, ndalimi lidhet vetëm në rastet e përcaktuara në kuptim të përkufizimeve të pikës 3 të nenit 91, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në vlerësim të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, konstaton se, nuk rezultoi e provuar se Ministri i Mbrojtjes, z. Peleshi është në shkelje të nenit 91, pika 3, të ligjit 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi:

- Ndërkohë që ndalimi i parashikuar në nenin 91, pika 3 të Kodit Zgjedhor, është vetëm *për marrjen në punë, pushimin nga puna, lirin, lëvizjen dhe transferimin në detyrë në institucionet apo entet publike*, personeli që fillon specializimet nga jashtë radhëve të Forcave të Armatosura nuk trajtohet financiarisht gjatë periudhës së specializimit. Në përfundim të kësaj periudhe, ky personel është i detyruar të paraqesë në Ministrinë e Mbrojtjes kërkesën për mundësinë e punësimit në shërbimin shëndetësor të Forcave të Armatosura, kërkesë e cila shqyrtohet sipas nevojave që Ministria e Mbrojtjes ka. Për rrjedhojë nuk jemi në kushtet e “punës” sipas përkufizimit të përdorur në nenin 91 të Kodit Zgjedhor.
- I gjithë procesi nga aplikimi, verifikimi i dokumentacionit, dhënia e provimit, vlerësimi me pikë si dhe shpallja e personelit fitues ndiqet nga Universiteti i Mjekësisë.
- Numri i kuotave ishte më i lartë se numri i kërkesave të ardhura pranë Ministrisë së Mbrojtjes, e për rrjedhojë, mbështetur në CV e paraqitura nga personeli, në degën në të cilën janë diplomuar dhe në kërkesat personale në të cilën kanë kërkuar degën përkatëse për të ndjekur specializimin, Ministria e Mbrojtjes, sipas njoftimit të rektoratit ka pajisur personelin me letër mbështetëse përkatëse standarte.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, çmon se nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ, për denoncimit e qytetarit ndaj Ministrit të Mbrojtjes, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria e kryer nga Ministria e Mbrojtjes, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë:



V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj Ministrit të Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, pasi nuk konstatohen shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

